Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/22
Datë: 02.02.2024

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 26.01.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Akreditohet dhe validohet** Institucioni "Flutura Academy" SH.P.K me adresë: Rr. Shaban Shala nr. 99, në Gllogoc, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 26.01.2024 deri 25.01.2027, me kualifikimet e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

   1.1 **Zhvillues Softueri Junior,** Niveli IV sipas KKK, lloji: Kualifikim i bazuar në standarde ndërkombëtare (E) me 15 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit në katër (4) cikle trajnuese brenda vitit, me nga tre (3) grupe të trajnimeve brenda një cikli, me nga njëzetë (20) kandidat në grup gjithësej institucioni mund të realizoj 12 grupe trajnuese brenda vitit për programin Zhvillues Softueri Junior.

   1.2 **Kurse të Gjuhës Gjermane Niveli A1-B1**. Institucioni Flutura Academy mund ta realizoj procesin e trajnimit për gjuhë gjermane me dy (2) grupe brenda vitit, me nga 15 kandidatë në grup.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Institucioni "Flutura Academy" SH.P.K. me datë 03.04.2023 ka parashtruar në AKK kërkesë për akreditim dhe validim për kualifikimin Zhvillues Softueri Junior, niveli IV sipas KKK, si dhe për akreditim të kualifikimit Kurse të Gjuhës Gjermane niveli A1-B1. AKK bazuar në dispozitat

ligjore në fuqi ka zhvilluar procedurat për vlerësim të institucionit sa i përket plotësimit të kritereve të përcaktuara nga AKK sipas legjislacionit në fuqi. Ekipi i eksperteve i përcaktuar për vlerësim të kualifikimit Zhvillues Softueri Junior, niveli IV sipas KKK me datë 08.11.2023 ka shqyrtuar dokumentacionin e ofruar nga institucioni "Flutura Academy", ndërsa vizitën në këtë institucion e ka realizuar me datë 20.11.2023 për të vlerësuar nëse institucioni plotëson kushtet dhe standardet e kërkuar për akreditim dhe validim bazuar në dispozitat ligjore në fuqi. Pas realizimit të vizitës nga ekipi i ekspertëve në këtë institucion dhe trajtimit në detaje të dokumentacionit, ekipi i ekspertëve me datë 07.12.2023 ka përpiluar raportin vlerësues për akreditim dhe validim të kualifikimit Zhvillues Softueri Junior niveli IV i KKK.

Ndërsa ekipi i eksperteve i përcaktuar për kualifikimin Kurse të Gjuhës Gjermane niveli A1-B1 ka shqyrtuar dokumentacionin e ofruar nga institucioni me datë 08.11.2023,vizitën në këtë institucion e ka realizuar me datë 20.11.2023, ndërsa raportin përfundimtar e ka përpiluar me datë 04.12.2023.

Në raportet përfundimtare ekipet e eksperteve kanë dhënë vlerësim pozitiv, dhe të njëjtat ia rekomanduan Këshillit Drejtues për vendimmarrje.

Rekomandimet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për akreditim dhe validim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimeve; Raportin e vetëvlerësimit; Vizitën e ekipeve të ekspertëve në institucioni "Flutura Academy", si dhe dokumente tjera shtesë.

Andaj, në bazë të kërkesës së institucioni "Flutura Academy", për akreditim dhe validim si dhe rekomandimeve përfundimtare të ekipeve të ekspertëve të dhëna në Raportet e vlerësimit për institucionin aplikues, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit "Flutura Academy"
2. Arkivit të AKK-së.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK-së